

Date: 28.07.2023.

## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 621-23-6991-2-3-6/C767

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë: dhe  
N.N." BRRUTI ING ", DRAGASH, BRRUT, 600751946, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën  
tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**062-Riparimi i kanalizimit në fshatin Kuk – K.K. Dragash me numër identifikues: 621-23-6991-2-3-6, dhe  
nr, te mbrendshem 621-2023-062-236.**

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

**Riparimi i kanalizimit në fshatin Kuk – L=120m’ •si dhe elemente tjera të specifikuara në dosjen e  
tenderit**

| No. | Lot  |
|-----|--|
| 1   | 062-Riparimi i kanalizimit në fshatin Kuk – K.K. Dragash |

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **4,903.46** €; ( kater mij e nenteqind e tre Euro e dyzet e gjashte cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka  
borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të  
paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga  
njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të  
identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në  
komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe  
transaksionet që lidhen me thesarin.

kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën <sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

#### Për Autoritetin Kontraktues

|             |   |
|-------------|---|
| Emri:       | Nuro Ismaili 062/2023   |
| Pozita:     | Zyrtar përgjegjës-i prokurimit  |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 28.07.2023.   |
| Vula:       |  |

#### Për Ofruesin e Shërbimeve

|             |   |
|-------------|---|
| Emri:       | N.N." BRRUTI ING ",<br>DRAGASH, BRRUT,<br>600751946                                 |
| Pozita:     |   |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 28.07.2023.   |
| Vula:       |  |



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 621-23-6991-2-3-6/C767

## Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoriteti kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditësh pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të fillojë shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë para lajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të para lajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## **Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafël të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pacaktueshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

## **Neni 12            Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13            Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrës dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## **Neni 14            Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e moszekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 15            Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## **Neni 16            Parimet e përgjithshme të pagesës**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17                    Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18                    Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19                    Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20                    Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqien të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

## **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## **Neni 22 Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë së sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

**PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*


| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës       |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK   |
|---|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit                        | Neni. Nr. |   |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha              | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.  |
|   | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuhët në përdorim zyrtarë</b> .   |
| Siguria e ekzekutimit                     | 10.1      | n/a   |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2      | Shuma minimale e sigurimit do të jetë:<br>(a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ;<br>(b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ;<br>(c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ;<br>(d) dëmtim personal ose vdekje:<br>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i><br>(ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i> |
| Programi                                  | 12.1      | .<br><b>Planin për Menaxhimin e Kontratës.</b><br><b>Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës</b>  |
|   | 12.2      | Periudha për Programin e azhurnuar është <b>2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.</b>  |
| Fillimi i punëve                          | 17.1      | <b>Data e fillimit do të jetë : 2 (Dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës,( vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues</b>  |
|   | 17.2      | <b>Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës – 10 ditë kalendarike, ose deri me date 10.08.2023.</b>  |

|                                      |      |  |
|--------------------------------------|------|--|
| Dëmet e likuiduara                   | 19.1 | <p><b>Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë.</b></p> <p><b>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.</b></p>  |
| Regjistri i punës                    | 20.1 | [ <i>Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet</i> ].   |
| Inspektimi dhe testimi               | 22.1 | <p><b>Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues.</b></p> <p><b>Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.</b></p> <p><b>Menagjer i projektit nga AK eshte: Sabahat Hasani</b></p> <p><b>Menagjer mbikqyres i kontrates nga AK eshte:Nuhija Tahirovci</b></p> <p><b>Menagjer i projektit nga OE eshte:Perparim Jusufi</b></p> |
| Pagesa                               | 24.2 | <b>Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- do të realizohet pas perfundimit te punimeve te percjellura me raport nga ana e menaxherit te kontrates dhe raportit nga ana e komisionit te pranimit teknik te projektit.</b>   |
| Parapagimi                           | 26.1 | <b>Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake.</b>   |
| Mbajtja e Parasë                     | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: [ <i>shëno përqindjen</i> ]  |
| Shkaqet për kompensim                | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë [ <i>shëno numrin</i> ] ditë pas nënshkrimit të kontratës.   |
| Përgjegjësia mbi Defektet            | 34.5 | <p><b>Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.</b></p> <p><b>Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.</b></p>   |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës   | 39.1 | <b>Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>  |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | <b>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë së Drejtësisë</b>  |
| Zgjidhja e                           | 43.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të   |


|  |   |
|--|---|
| <p>mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore</p> | <p>lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në <b>Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</b></p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</b></p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p> |
|--|---|

## Riparimi I Kanalizimit ne fshatin Kuk

| Nr. rendor                           | Përshkrimi i pozicioneve   | Njësia         | Sasia | Çmimi njësi (€) | Çmimi total në TVSH (€) |
|--------------------------------------|--|----------------|-------|-----------------|-------------------------|
| 1.1                                  | Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet kanalizimi sipas projektit detaj, gjatë kohës së zezatit punimet. I log në m <sup>2</sup>  | m <sup>2</sup> | 120   | 0.20 €          | 24.00 €                 |
| 1.2                                  | Punët parapërgatitore, shënimi gjeodezik si dhe verifikimi i trasesë së vjetër të kanalizimit në matjet gjeodezike të përshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, po ashtu të maten duzyrvelet dhe të mundesohet kyçja e kolektorve të vjetër në kolektorin e ri, kyçja dhe shkarkimi i gropave septike ekzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit sipas projektit dhe detaleve teknike. I log në m <sup>2</sup>                                | m <sup>2</sup> | 120   | 0.20 €          | 24.00 €                 |
| 1.3                                  | Pastrimi i terrenit nga mbeturmat e ngjira ndërtimore shkarkimet drunjët e pyllezuar - në zonat ku do të kalojë traseja e kanalizimit . Pastrimi i tyre bëhet normal me mjedhën e kanalizimit me gerësi 5m për ti mundësuar lufjen normale të makinerisë për çerim si dhe largimin e tyre në depom . Depom e cakton investitori . Në këtë pozicion përshihet edhe demolimi i çellojave dhe këllimit në gjendjetë me parshme pas përfundimit të punimeve. I log në m <sup>2</sup> | m <sup>2</sup> | 120   | 0.50 €          | 60.00 €                 |
| 1.4                                  | Demolimi i rrjetit ekzistues të vjetër, pastrimi i terrenit dhe krijimi i kushteve ndërtimore për instalimin e rrjetit të ri. I log në m <sup>2</sup> me të gjitha shpenzimet  | m <sup>2</sup> | 120   | 1.00 €          | 120.00 €                |
| <b>GJITHËSËJ PUNIMEI PËRGATITORI</b> |  |                |       |                 | <b>588.00 €</b>         |
| <b>PUNËT E DHEUT</b>                 |  |                |       |                 |                         |
| 1.5                                  | Çerimi dhe hapja e kanalit për tokë tushorë të kategorisë III-VII në thellësi prej 0.8 m deri në thellësi 1.0 m për kanalizim. Tekat dhe gjerësi të nevojshme për punë duke përfshirë të gjitha pikat gjeodezike sipas profilit gjatësorë dhe dispozitës së projektit.<br>Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me vibrator pjesa e trasesë së kanalizimit   |                |       |                 |                         |
|                                      | Punët me makineri (90%)  | m <sup>3</sup> | 42.00 | 2.00 €          | 84.00 €                 |
|                                      | Punët me dorë (10%)  | m <sup>3</sup> | 48.00 | 1.00 €          | 48.00 €                 |




|                                   |  |                |        |         |                   |              |
|-----------------------------------|--|----------------|--------|---------|-------------------|--------------|
| 22                                | <p>Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi, ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së poshtës nga materiali emor para se të betonohet kimentar (Bazamenti poshtës)</p> <p>Trakston (0 deri 63 mm me trashësi të shtresës 1-20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet modul i ngjeshjes <math>M_v = 250 \text{ kg/cm}^2</math>. Materiali i përdorur duhet të jetë i pajisur me afeste parapraike edhe ato sipas normave dhe standardeve.</p> <p>Vrejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontrates</p> | m <sup>3</sup> | 1.16   | 6.00 €  | 6.91 €            | 6,96         |
| 23                                | <p>Furnizimi dhe shtrirja e Rërës 0-1mm, trashësi 10cm për shtretin nën gyp me planifikim 3cm, dhe 15 cm mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit, sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike parapraike të specifikuar për punimet tokësore. Gjate vendosjes së rerës të aplikohet planimetria të përcaktuar në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në veper. I log m<sup>3</sup></p>   | m <sup>3</sup> | 37.50  | 7.00 €  | 262.50 €          | ✓            |
| 24                                | <p>Largimi i njerave nëtokësore të cilët shfaqin gjate përmirimit të kanalit, të cilët pengojnë ecurin e punës në instalimin e rrjetit të kanalizimit. I log me 001 punë me aptovimin e organit mbikqyre</p>   | ore punë       | 2      | 10.00 € | 20.00 €           | ✓            |
| 25                                | <p>Vendosja e trakës mbrojtëse sinjalizuese me gjerësi 3 cm përgjate gjitha trasës së rrjetit të kanalizimit, për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.</p>   | m              | 120    | 0.10 €  | 12.00 €           | ✓            |
| 26                                | <p>Mbushja dhe mbulimi i kanalit pas vendosjes së gypit me asfalt dheut të perzgjedhur pa gurë me trashësi sipas skicave dhe detaleve të përcaktuara në projekt për secilin pjesë: stacionazh, pastaj vendoset pjesa tjetër e dheut deri në mbushje përfundimtare të terrenit dhe kihimi në gredhe të mëparshme, dheu i repet bëhet në deponim me të afert deri në 15 km largësi</p>   | m <sup>3</sup> | 100.00 | 0.10 €  | 100.00 €          | ✓            |
| 27                                | <p>Furnizimi, transporti dhe montimi i palive për mbrojtjen e kanalit nga shembja e dheut. Palat duhet të vendosen në 1.50m distancë e kanalit</p>   | m <sup>2</sup> | 960.00 | 0.10 €  | 96.00 €           | ✓            |
| <b>GJITHËSHEJ PUNIMIT E DHEUT</b> |  |                |        |         | <b>1.605.41 €</b> | <b>1605,</b> |




| PUNËT E TITULLIT (VENDOSJA E GYPAVE TË KANALIZIMIT) |  |                |     |          |                   |   |
|---|--|----------------|-----|----------|-------------------|---|
| 1.1   | Furnizimi dhe montimi i tubave të betonit Ø800 mm nga beton i parafabrikuar i papershkueshëm nga uji për rregullimin e pusetave. Pusetat janë të thella me shtari-shte deri në 1m, me këto pozicion të kihet parasysh që duhet të vendosen mesatarisht 1 gypa ka 1 metër për pusetat. Kompania ekzekutive është e obliguar që ta bëjë montimin dhe lidhjen në mes gypave në mënyrë profesionale duke filluar për montimin të gypit mbi këmbet dhe vazhdon me lartësi të ngritje deri të kuota gjeodezike të përcaktuara në profilin gjatësorë të projektit të përshirë edhe kontuset pa kapakë. Lidhja e gypave në mes veti bëhet me llaç çimentoje.   | cope           | 2   | 100.00 € | 200.00 €          | ✓ |
| 1.2   | Riparimi i dy pusetave ekzistuese, në të cilat do të bëhet lidhja e kanalizimit të ri.   | cope           | 2   | 50.00 €  | 100.00 €          | ✓ |
| 1.3   | Furnizimi dhe vendosja e kapakeve të pusetave Ø600 mm nga materiali metalik (grazi) izoluar me diktin nga goma për mos depërtimin e ujrave atmosferike në pusetat e kanalizimit fekal. Sipas detali të prezantuar në projekt.  | cope           | 1   | 200.00 € | 200.00 €          | ✓ |
| 1.4   | Vendosja e umazave për nivelizimin e depërtimit të gypit të di të futet në pusetat betoni me dimenzionet sipas projektit, dhe mbështetë në këmbet për shkarkimin e kontrolluara të ujit kanalizimit në pusetat me kapacitet dhe në depërtimin e pusetës duhet përforcimet me llaç me raport 1:1 sipas skemës së projektit.<br>Verejtje: Gjate ekzekutimit të punimeve duhet pastruar kujdes që të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme që parandalohet rrjedhja para se të futet në pusetat ujit fekal dhe mos shkaktohen ndotje ambientale.   |                |     |          |                   |   |
|   | Umaza DN 315mm   | cope           | 10  | 3.00 €   | 30.00 €           | ✓ |
| 1.5   | Furnizimi dhe vendosja e gypave nga Materiali HDPE kualiteti PSN 8, përgjatë gjatë gjatë dhe në rreze të kanalizimit, duke përfshirë nivelimin dhe përfundimin e ramjes në bazë projektit, me të gjitha elementet përfunduese duke vendosur umaza nga goma ku lidhen gypat për të parandaluar lëvizjen e gypave dhe duke përfunduar hyrjen e gjesendeve të ngurta të cilat bllokojnë gypin. Gjate ekzekutimit të projektit të respektohen detallet teknike të përfshira në prirjen teritoriale dhe gjatësore po ashtu të respektohen kriterat gjeodezike të përfshira në projekt. Verejtje: Punëkruesi pasi të fillojë vendosjen dhe instalimin e gypave duhet të dorzojë atestet e materialeve konform specifikacionit teknik të projektit. |                |     |          |                   |   |
|   | GYP HDPE PSN 8 DN 315 mm   | m <sup>2</sup> | 120 | 18.00 €  | 2.160.00 €        | ✓ |
| <b>GJITHËSIA PUNIMEVE TITULLIT</b>                  |  |                |     |          | <b>2.710.00 €</b> | ✓ |

| 5. REKAPITULIMI -KANALIZIMI FEKAL NE RRUGEN "GURI" L=300m' |                                |                   |
|--|--------------------------------|-------------------|
| 1  | GJITHËSIA PUNIMEVE PREGADITORE | 588,00 €          |
| 2  | GJITHËSIA PUNIMEVE DHE TË      | 1.605,46 €        |
| 3  | GJITHËSIA PUNIMEVE TITULLIT    | 2.710,00 €        |
| <b>TOTALI ME TVSH</b>                                      |                                | <b>4.903,46 €</b> |

= 4903,46





02 - Kryetari i Komunës  
Nr. 100/2023 17903/23  
Dt. 26.07.2023  
Dragash

Kryetari i Komunes, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhezuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerre:

### V E N D I M

**Caktohet** menaxheri i kontrates dhe mbikqyresi në realizimin e kontrates **062-Riparimi i kanalizimit në fshatin Kuk – K.K. Dragash** me numër identifikues: **621-23-6991-2-3-6**, dhe nr, të mbrendshëm **621-2023-062-236**.


**Sabahat Hasani** -caktohet menagjer i kontrates,

**Nuhija Tahirovci**-Mbikqyres i drejteperdrejt i menagjerit të kontrates

Menaxheri i kontrates, obligohet që të hartojë një plan të menaxhimit të Kontrates, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e të dy paleve (Menaxherit të Kontrates së AK dhe Menagjerit të Kontrates së OP) para inicimit të zbatimit të kontrates dhe një kopje të nënshkruar të planit për menaxhimin e kontrates do ta përcjellë tek departamenti i prokurimit.

1. Menagjeri i kontrates e menagjon kontraten deri në pranimin e plote të punëve të kerkuara-kontraktuara, respektivisht deri në përfundimin e kontrates.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Kryetari i Komunes:



Vendimi u dërgohet: menagjerit të projektit,  
Mbikqyresit të kontrates,  
Zyres së Prokurimit,  
Drejtorit të Drejtorisë përkatëse,  
Arkivit të Komunes (kryetarit).